

Raport Vleresimi Ndikimi ne Mjedis sipas VKM-686 date 29.07.2015

a) përshkrimi i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar dhe me fotografi;

Zona ku propozohet ndertimi I hidrocentralit eshte zone malore. Gjurma qe prek projekti kryesisht eshte shtrat perroi per ndertimin e vepres se marrjes, dekantuesit, basenit te presionit dhe godina e centralit. Tubacioni i turbinave me dimensione 508/603mm kalon ne pllajen natyrore te malit ne nje zone te zhveshur me bimesi te ulet bar sezonal dhe shkure te uleta. Ne pjesen e fundit ne afersi te godines se centralit zona ka shkure te larta dhe peme te cilat pjeserisht duken te thara. Per sipërfaqet e germuar dhe pemet e prera do te realizohet rehabilitimi sipas planit te miratuar nga drejtoria pyjore e Bashkise Tepelene. Bashkengjitur po ju paraqesim disa foto nga zona;



Foto nga pozicioni i Vepres se Marrjes



Foto nga pllaja ku do te kaloje tubacioni i turbinave



Foto nga pozicioni i godines se centralit

b) informacion për praninë e burimeve ujore, në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të tij;

Fillimi i perroit te Mezhegoranit ka burime ujore ne kuoten e fshatit mbi vepren e marrjes. Vepra e Marjes kap sasine e ujit qe mbetet nga perdorimi i fshatit per nevojat e tyre. Ne asnje rast heci nuk cenon perdorimin e ketyre burimeve pasi eshte shume poshte si kuote. Po ju paraqesim foto te burimit.



Foto nga burimi mbi vepren e marjes ne kuoten e fshatit Mezhegoran

c) informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundshme, negative, në mjedis, të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër;

1. Bimet e ujit

Ne zonen ku do të merret uji nuk ka bime uji, për vetë morfologjinë që ka përroi, dhe për karakterin abraziv të tij, po kështu edhe në zonen ku do të ndërtohet ndërtesa e centralit. Nga ky aktivitet nuk do të ketë demtime të tyre.

2. Flora dhe Fauna

Zona sic është përshkruar edhe më lart, nuk është e mbushur me bimësi, pasi tubacioni që do kalojë nëpër formacione shkëmbore. Fauna e zonës, sidomos ajo ujore, nuk pëson ndonjë ndryshim të ndjeshëm nga ky projekt. Pjesa e perroit në rrjedhën e poshteme mbas ndërtimit të Hec-it Bregu i Lerës, nuk konsiderohet e mbushur me peshq pasi këta janë perrenj malorë dhe shtrati është me zhavorë ku në vende të caktuara uji në periudhën ujepaket humbet dhe rrjedh poshtë gureve.

Aktiviteti i ndërtimit të shfrytëzimit nuk sjell influencë negative në folelizim, shumëzim, etj. Gjate fazës së shfrytëzimit nuk ka elemente të shqetësimit për demtimin e faunës.

Po ashtu edhe fauna e zonës mbetet e paprekshme nga ndikimet e ndërtimit të kësaj prite, për arsye se aktiviteti i ndërtimit dhe shfrytëzimit nuk demton në lloje dhe në numër elementet e flores dhe faunës, si pjesë përberëse e kësaj zone.

Pra, si përfundim theksojmë se ndërtimi i Hec-it Bregu i Lerës, dhe shfrytëzimi i tij nuk e demton floren dhe faunën e kësaj zone. Ndërtimi i Hec-it Bregu i Lerës, do të jetë një ndihmë e madhe për këtë zonë për vetë kushtet për kërkese të madhe për energji elektrike që po kalon vendi ynë dhe rajoni.

3. Humbja dhe demtimi i tipareve gjeologjike, paleontologjike, problemi i mjedisit gjeologjik

Në pikepamje të strukturës gjeologjike dhe pamjes së relievit, kjo zonë nuk ka vlerë tipike dalluese dhe nuk ka asnjë arsye të vlerësohet ose të merret parasysh gjatë këtij aktiviteti. Kjo zonë përben një peisazh të zakonshëm gjeologjik-gjeomorfologjik, karakteristike të këtij rajoni.

ç) një përshkrim për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve;

1. Ndikimet fizike të projektit në ndryshimet e topografisë së zonës, tokës, etj.

Gjatë ndërtimit të Hec-it Bregu i Lerës, dhe të projekteve përkatëse, do të ketë ndryshime pothuajse të papërfilleshme të topografisë lokale. Në projektet e tij janë parashkruar një rradhë ndërhyrjesh që në kombinim me masat e tjera suplementare të sistemit dhe trajtimit, parandalojnë erozionin e mundshëm.

Gjate ndertimit te kanaleve per tubacionin nuk pritet te kete ndryshime ne topografine lokale. Ne projekt eshte parashikuar nje rradhe pune dhe drejtim i tille, qe ne kombinim me masat e tjera suplementare te mbushjes, sistemimit dhe trajtimit, te parandalojne fenomenin e erozionit:

- Ndikimet ne perdorimin e tokes dhe te burimeve ujore
- Ne cilesine dhe sasine e tokes are

Siperfaqja qe do te perdoret per kalimin e kanaleve dhe te tubacioneve te Hec-it Bregu i Lerës, eshte kryesisht shoqeruese e pllajes se lugines se Mezghoranit. Pra nuk kemi te bejme me toke bujqesore. Ndertimi i ketyre veprave hidroteknike dhe i godines se hidrocentralit ne kete zone, nuk ndikon negativisht ne cilesine dhe sasine e tokes are. Ne zonen e ndertimit te veprave hidroteknike, hap pas hapi eshte parashikuar sistemimi i terrenit me bar dhe si pasoje zhvillimin e bimesise spontane te mepareshme.

2. Ne cilesine dhe sasine e tokes

Siperfaqja ne te cilen do te ndertohet Hec-i Bregu i Lerës, (veprat e marrjes, dekantuesi, baseni i presionit, tubacioni i turbinave dhe ndertesa e centralit) nuk eshte toke bujqesore. Ndertimi i ketij hidrocentrali nuk perben asnje problem per sa i perket cilesise se saj.

3. Ndikimet ne uje

Ndertimi i Hec-it Bregu i Lerës, nuk sjell asnje problem ne sasine e marrjes se ujit ne ky perrua per komunitetin, pasi eshte llogaritur prurja per cdo muaj dhe per 12 muajt e vitit. Ne cdo kohe do plotesohen nevojat e komunitetit per vaditje dhe prurja ekologjike qe i korespondon prurjes qe vjen 355 dite te vitit. Zbatimi i projektit nuk do te ndikojte negativisht ne ujrat siperfaqesore, pasi nuk do te krijohen basene te medha per rregullimin e regjimit te prurjeve dhe përroi qe krijohet nga ky burim nuk do te thahet dhe te krijojte probleme me shtratin e tij.

4. Ndikimet e ndotesve dhe mbetjeve ne cilesine e ujit

Gjate ushtrimit te ketij aktiviteti nuk do te kete ndikim ne cilesine e ujit, si nga veprat e marrjes, tubacionet e turbinave, turbina dhe daljen e tij ne perrua.

5. Ndikimet ne ajer

Ushtrimi i ketij aktiviteti nuk ka ndikim ne cilesine e ajrit te zones, mbasi gjate shfrytezimit nuk do te kete emetime te gazrave.

6. Ndikimi ne klime

Gjate ushtrimit te ketij aktiviteti nuk ka ndikim ne klimen e kesaj zone.

7. Aromat sulmuese

Gjate ushtrimit te ketij aktivitetj nuk ka emetime te aromave te ndryshme te cdo lloji qofshin ato.

8. Ndikime te tjera klimatike

Gjate ushtrimit te ketij aktiviteti nuk priten ndryshime te dukshme klimaterike, si ne drejtim te permiresimit ashtu edhe ne ate te perkeqesimit te saj.

9. Ndikime te tjera indirekte dhe sekondare, qe shoqerojne projektin

Projektet e tjera si p.sh. rruget e reja, kanalet e ujrave te zeza, banesat, linjat e energjise, telekomunikacionet, etj. nuk do te ndikojne ne realizimin e ketij projekti, pasi ne gjurmen e projekt nuk ka elemente te infrastruktures sic u permenden me lart.

10. Ndikimet shoqeruese te projektit me projekte te tjera ekzistuese ose te propozuara

Ushtrimi i ketij aktiviteti do te ndikojte pozitivisht ne zhvillimin e infrastruktures dhe ne rritjen e nivelit socia-ekonomik ne rajon.

d) informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuar;

Ndikimet e pritshme jane gjate fazes se ndertimit si zhurma, pluhur dhe inerte. Per te gjitha keto ndikime te pritshme eshte parashikuar ndalimi gjate gjithë kohes i borive dhe kufizim i levizijes se mjeteve ne orarin 6.00-8.00 dhe 15.00-17.00 pasi banoret e fshtit levizin ne keto orare. Per te eliminuar pluhurin do te laget traseja ku do punohet me qellim uljen e pluhurit ne ajer gjate punimeve. Per inertete e nxjera nga germimi qe nuk do te perdoren do te depozitohen ne vendgrumbullimin e miratuar nga pushteti vendor.

dh) të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësimore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit, dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të;

Nuk pritet te kete ndikim negative ne hapesiren ne afersi te projektit pasi madhesia e projektit eshte shume e vogel per te ndikuar ne zonen ne afersi te saj

e) mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin;

Per rehabilitimin e mjedisit eshte parashikuar ne preventiv kthimi i siperfaqes se germuar ne gjendjen e meparshme duke mbjell bar dhe duke bere planin e rehabilitimit te percaktuar me drejtorine e pyjeve ne Bashkine Tepelene. Per rehabilitim te rrugeve eshte parashikuar fondi ne preventiv rreth 678,360 leke.

ë) masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;

1. Perdorimi tokes

Ndertimi i veprave hidroteknike te Hec-it Bregu i Lerës, nuk krijon shqetesim per komunitetin perreth, si gjate fazes se ndertimit ashtu dhe ne fazen e shfrytezimit. Punimet e ndertimit do te vazhdojne per nje periudhe te vogel kohe dhe nuk do te krijohen demtime te tokes. Nuk ka mbetje demtuese ne siperfaqen ku do te vendosen pritrat, ku do te hapen kanalet dhe vendosen tubat e sjelljes se ujit. Per sa i perket tubacionit te turbinave ato nuk japin ndonje ndryshim ne peisazh, per arsye se ato jane punime nentoke dhe nuk duken ne siperfaqe. Por duhet te theksojme qe permasat e ketyre kanaleve jane te vegjel me nje gjeresi 1.5 m dhe thellesi rreth 2.0 m, te cilet do te mbulohen dhe rehabilitohen dhe nuk duken nga larg. Ne keto kanale do te vendosen tuba Çeliku 609.6/508.0mm te cilat do te mbulohen dhe rehabilitohen me mbjellje bari.

Per sa i perket ndertimit te nderteses se Hec Bregu i Lerës ajo nuk do te vendoset mbi toke buke, por mbi taracen e vjeter te përroit ne nje disnivel nga shtrati i sotem ekzistues, i cili nuk do te krijoje asnje problem ne rast reshjesh. Duhet te theksojme edhe njehere se i gjithe kompleksi i ndertimit te Hec Bregu i Lerës duke filluar nga veprat e marries, dekantuesi, baseni i presionit, tubacioni i turbinave dhe ndertesat hidrocentralit nuk vendosen ne toke buke, por vetem ne shtratin e perroit dhe pllajen e malit.

2. Ndikimi tek njerezit, ndertesat dhe objektet e ndertuara nga njeriu

2.1 Ndikimi ne populisi

Ndertimi i Hec Bregu i Lerës, ne kete zone nuk ka per te sjelle probleme per komunitetin e kesaj zone. Realizimi i ketij projekti, duke mos patur nevojte per krijimin e nje rezervuari, nuk do te shkaktoje ndryshime ne popullsi te saj, apo zhvendosje te saj per shkak te ketij aktiviteti.

Nderkohe duhet te theksojme qe ndertimi i Hec-it Bregu i Lerës, do te kete avantazhe te medha, per banoret e kesaj zone pasi do te permiresohet furnizimi me energji elektrike nga rrjeti 10kV.

Nderkohe duhet theksuar dhe fakti qe ne kete aktivitet mendohen te punesohen nje numer i konsiderueshem punonjesish duke zbutur sadopak plagen e papunesise.

2.2 Ndikimet ne peisazh

Kemi theksuar se karakteristike e Hec-it Bregu i Lerës, eshte ruajtja dhe mos ndryshimi i pejsazhit te saj, prandaj peisazhi nuk ka per te patur asnje demtim domethenes dhe do te kete nevojte per rigjenerim minimal per periudhen e shfrytezimit te Hec-it.

3 Ndikimet e rrjetit mbi trashgimime arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe vepra te tjera njerezore

Si rezultat i ndertimit te Hec-it Bregu i Lerës ne kete zone, nuk ka dhe nuk do te kete ndikime negative mbi trashegimime arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe mbi vepra te tjera njerezore, sepse ne zone dhe perreth saj, nuk ka objekte te nje rendesie te vecante te karaktereve te mesiperme. Gjate germimeve do te monitorohet nga specialist arkeologjie i licensuar.

4 Ulja e intensitetit te erozionit dhe zbutja e ndryshimeve te topografise

Qellimi i projektit lidhet me ndertimin e Hec-it Bregu i Lerës, per prodhimin e energjise elektrike nderkohe qe mungesa e saj po krijon shume probleme ne Shqiperi edhe ne rajon perreth. Cmimi i blerjes ne tregun boteror eshte afersist 5-fishi i cmimit qe blihet nga prodhuesit vendas te energjise.

Per te ruajtur ekuilibrin mjedisor do te merren keto masa:

- Mirembajtja e veprave hidroteknike, tubat e sjelljes se ujit si dhe nderteses se centralit per mos lejimin e permbytjeve nga rrjedha ujore dhe prurjet e ngurta ne raste te shirave te rrembyeshem.
- Ne raste te tilla ose ne rast avarish do te behet derdhja direkt ne përrua, tubacioni i te cilit eshte ne ato permasa qe te marre te gjithë sasine e ujit. Por ne rast avarish te medha pritat jane realizuar me porta qe hapen e mbyllen sipas kerkesave qe bejne menjehere bllokimin e hyrjes ujit ne tubacionin e derivacionit.

f) ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë).

Nuk ka mjedis nderkufitar ne zonen e projektit te propozuar.

PERGATITI

Ing. Andrin KËRPAÇI

Ekspert Mjedisi